



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 (c), nenin 65.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenin 5 paragrafi 1.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.03.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **ZNJ. ZEJNEPE OSMANI** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Viti, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Vjollca Kadolli Halili.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Viti, që ky vendim t'i komunikohet znj.Zejnepe Osmani, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 12.10.2018, Nr.679/2018, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit znj. Vjollca Kadolli Halili, pas dorëheqjes së saj të parevokueshme, për arsye se është zgjedhur drejtoresh në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Viti.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, e cila është, znj. Zejnepe Osmani nga i njëjti subjekt politikë gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 28.03.2018

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka